

PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E TË
DREJTAVE TË FËMIJËVE NË KOMUNËN E
PRISHTINËS
2019– 2021

Prishtinë, 2018

PARATHENIE

Plani i Veprimit (2019 - 2021), për Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Komunën e Prishtinës është hartuar nga Grupi Punues Komunal i Komunës së Prishtinës, i caktuar me Vendimin 01.nr.14-020/04-0160563/18 të dt. 05-07-2018)¹ të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në partneritet dhe bashkëpunim me programin për të Drejtat Civile (CRP-K), me financimin e Bashkimit Evropian, menaxhimin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe mbështetjen e Koalicionit të Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF).

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Planit të Veprimit është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve nga autoritetet lokale, përmes bërjes së komunës mike dhe të sigurtë për të gjithë fëmijët e Komunës së Prishtinës, me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të fëmijëve, duke u udhëhequr nga interesi më ilartë i fëmijës. Qëllimi tjetër i hartimit të këtij dokumenti, është që të orientojë dhe mbështesë punën e Komunës së Prishtinës, si një komunë mike në mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, duke marrë në konsiderim kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të siguruar funksionimin e tyre të plotë.

Plani është hartuar në përputhshmëri të plotë me Rregulloren Komunale për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve, që poashtu është një reflektim legjislationit vendor dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

¹Vendimi 01, Nr. 12-020/04-0160563/18 të dt. 05-07-2018 , i caktuar nga Kryetari i Prishtinës, Z. Shpend Ahmeti

Komuna e Prishtinës, e cila sipas të dhënave statistikore vetëm në vitin 2017, vlerësohet të ketë pasur 210.282 persona², dhe natyrshëm edhe një nga Komunat me më së shumti fëmijë në Republikën e Kosovës, në misionin dhe vizionin e sajë e ka mirëqenien dhe sigurimin e cilësisë së të jetuarit për qytetarët e sajë, si edhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase dhe cilësore në funksion të mirëqenies së qytetarëve të sajë.

Ky Plan i Veprimit synon të mbështesë edhe më shumë jetësimin e misionit dhe vizionit të Komunës së Prishtinës.

Lidhur me këtë, në vijim janë dhënë objektivat e këtij Planit të Veprimit dhe një përshkrim i tyre për të kuptuar më drejtë qëllimin e këtij Plani të Veprimit,

- (1) **Pjesëmarrja dhe fuqizimi i fëmijëve:** Komuna e Prishtinës do t'i përfshijë fëmijët, në të gjitha vendimet që do t'i marrë lidhur me fëmijët dhe çështjet e tyre.

Përshkrim: fëmijët do të jenë palë në të gjitha proceset e vendimmarrjes për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ata duke konsideruar interesin më të mirë të tyre, dhe kontributi i tyre do të vlerësohet dhe njihet nga organet komunale.

- (2) **Shëndeti, mirëqenia dhe arsimimi i fëmijëve:** Komuna do të promovojë kujdesin shëndetësor, arsimor-edukativ dhe kujdesin alternativ.

Përshkrim: Komuna përmes departamenteve përkatëse do të promovojë mirëqenien e fëmijëve në fushat që direkt ndërlidhen me gjendjen e tyre psikofizike, sociale-ekonomike dhe arsimore. Në

²Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2017, AgjenciaStatistikore e Kosovës, Qershor 2018

këtë drejtim, Komuna do të organizojë fushata me prindër, mësimdhënës, profesionistë mjekësor, punëtorë social, dhe të tjerë nga komuniteti lokal.

- (3) **Parandalimi dhe eliminimi i dukurive abuzuese:** Komuna do të promovojë mbrojtjen dhe parandalimin nga abuzimi, dhuna dhe shfrytëzimi, apo çfarëdo rreziku tjetër. Komuna brenda kompetencave të veta do t'ju ofrojë qasje dhe trajtim fëmijëve të cenueshëm dhe në nevojë për shërbime të mbrojtjes në Komunën e tyre. Komuna do të mobilizohet më tej, përmes Departamenteve përkatëse që të ofrojë shërbime emergjente dhe të vazhdueshme për kategoritë e fëmijëve në nevojë të tillë. Komuna poashtu do ta përforcojë sistemin e referimit për rastet e abuzimit të fëmijëve.

Përshkrim: Komuna do të gjejë mënyra dhe mjete që të parandalojë dhe eliminojë dukuritë abuzive ndaj fëmijëve, përmes shërbimeve të saja profesionale dhe poashtu duke ndërgjegjësuar popullatën së cilës ajo i shërben. Lidhur me këtë, departamentet përkatëse brenda Komunës së Prishtinës do të bashkëpunojnë ngushtë për të ofruar shërbime sa më profesionale dhe të përshtatshme për të gjithë fëmijët në nevojë, poashtu duke identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për mbrojtjen e fëmijës.

- (4) **Sigurimi i mjedisit mbrojtës për fëmijë:** Komuna do të sigurojë qasje në hapësira dhe të mundësojë lojëra dhe argëtim për të gjithë fëmijët e komunës.

Komuna brenda juridiksionit të sajë do të bëjë të gjitha përpjekjet që të përmbushë obligimet ligjore për realizimin e të drejtave të fëmijëve, duke u mundësuar dhe lehtësuar qasjen në lojëra dhe argëtim fëmijëve të Komunës së vetë, në përshtatshmëri me nevojat në rritje dhe planifikimin në Komunë.

(5) **Sigurimi i kushteve elementare për fëmijë:** Komuna do të vlerësojë dhe mundësojë qasje në ujë të pijshëm dhe në higjienë.

Përshkrim: Komuna do të mundësojë qasje në ujë të pijshëm dhe kushte tjera higjienike, veçanërisht për fëmijët në zonat rurale, dhe fëmijët e marginalizuar. Megjithëse, në përgjithësi Komuna e Prishtinës, qëndron relativisht mirë sa i përket qasjes në ujë të pijshëm dhe higjienë ende ka për t'u bërë, dhe se për këtë Komuna përmes departamenteve të saja përkatëse do të identifikojë dhe rrjedhimishtshërë të gjitha burimet, që së paku të sigurojë ujin e pijshëm dhe higjienën për të gjithë fëmijët nën juridiksionin e sajë.

(6) **Përgjegjësia për mbrojtjen e fëmijëve:** Komuna do të caktojë së paku një person përgjegjës për të drejtat e fëmijëve që i raporton Kryetarit për gjendjen e të drejtave të fëmijëve

Përshkrim: Komuna e ka të trashëguar një organogram, të parashikuar me Njësitë Komunale³ për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (NJKDNJ), brenda së cilës Njësi që udhëhiqet nga Koordinatori për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, midis shtatë (7) zyrtarëve të caktuar për lloje dhe kategori të ndryshme të mbrojtje së të drejtave të njeriut, ekziston një zyrtar i caktuar për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve. Megjithatë, edhe pse këta zyrtarë ekzistojnë në Komuna, bazuar në Udhëzimin për themelimin e NJKDNJ nga më lartë, korrigjimet dhe përshtatjet duhet bërë karshi katalogut për vendet e punës të vitit 2015⁴ (me përditësimet e vitit 2018), në mënyrë që mos të ketë lëshime në funksionimin e zinxhirit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal.

(7) **Bashkëpunimi dhe bashkërendimi:** Komuna do të bashkëpunojë me të gjitha komunat, institucionet publike dhe OSHC-të në përmbushjen e detyrave të saja ligjore.

³Udhëzimi Administrativ, Nr. 2011/04-MAPL për Themelimin e Njësitë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut,

⁴Katalogu i Vendetë Punës në Shërbimin Civil të Kosovës 2015 (me përditësimet e vitit 2018), Ministria e Administratës Publike, Kosovë

Përshkrim: Komuna do të përfshijë të gjitha palët e interesuara publike dhe jopublike, dhe sipas nevojës, komunitetin e donatorëve, dhe do të konsultohen gjerësisht në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët, në mënyrë që bashkërisht të gjejnë zgjidhje (veçanërisht, në rastet kur janë përtej kapaciteteve të brendshme të Komunës), për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta që kanë të bëjnë me fëmijët, sipas standardeve dhe politikave të përcaktuara të Komunës. Në të njëjtën mënyrë, Komuna poashtu, në të ardhmen do të bashkëpunojë për përgatitjen e cilitdo plan që ka të bëjë me fëmijët.

(8) **Mekanizmi Koordinues Institucional:** Komuna do të themelojë Mekanizmin Koordinues për mbrojtjen e fëmijëve, sipas mandatit të vetë ligjor.

Përshkrim: Krijimi i Mekanizmave formal llogaridhënës (dhe sipas nevojës) në nivel lokal që do të merret me mbrojtjen dhe monitorimin e realizimit të të drejtave të fëmijës dhe të gjitha çështjeve që lidhen me fëmijët në mënyrë multiprofesionale dhe gjithëpërfshirëse.

(9) **Legjislacioni dhe politikat për mbrojtjen e fëmijëve:** Komuna do të vlerësojë ndikimin dhe hartojë politika dhe akte ligjore lokale për fëmijët dhe gjendjen e fëmijëve në Komunë.

Përshkrim: Hartimi i politikave dhe akteve ligjore për fëmijët dhe gjendjen e fëmijëve në Kosovë, që i përkasin nivelit lokal, dhe veçanërisht lehtësimi i kushteve për zbatimin e legjislacionit dhe ndikimin duhet të vihen, dhe mirëmbahen nga zyrtarët përgjegjës të caktuar komunal.

(10) **Raportimi dhe mbikëqyrja:** Komuna do të vendosë një sistem të raportimit për gjendjen e fëmijëve që i përgjigjet mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Përshkrim: Raportimi vertikal dhe horizontal, përmes drejtorive përkatëse, poashtu duhet praktikuar dhe zbatuar brenda komunës, por edhe me nivelin qendror për çështje të caktuara duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Një metodë erregullt e raportimit dhe raportimi sipas nevojës për gjendjen e fëmijëve duhet bërë rregull, në mënyrë që këto Raporte, pastaj t'i shërbejnë sa më mirë përmirësimit të gjendjes së fëmijëve në Komunë.

- (11) **Buxhetimi për fëmijët:** Komuna do të përcaktojë planin buxhetor për realizimin e të drejtave të fëmijëve nën juridiksionin e vetë.

Përshkrim: Çështja e ndarjes së buxhetit të përshtatshëm për fëmijë ka qenë dhe është sfidë me të cilën ballafaqohet edhe niveli lokal. Përkundër harmonizimit të legjislacionit vendor me legjislacionin ndërkombëtar për fëmijët, sa i përket çështjes së buxhetit, nuk ka ndonjë risi, dhe për këtë arsye duhet mobilizuar të gjitha organet komunale në mënyrë që komuna të përshtatë nevojat e fëmijëve nën juridiksionin e vetë, me shpenzimet që duhet bartë Komuna varësisht nga kategoritë e fëmijëve në nevojë. Prandaj, Komuna do të zhvillojë plane të buxhetit për fëmijë dhe do t'i përditësojë ato karshi shpenzimeve dhe shërbimeve të nevojshme për fëmijë.

- (12) **Vetëdijesimi dhe arsimimi për të drejtat e fëmijëve:** Komuna do të promovojë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve bazuar në Rregulloren Komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Përshkrim: Njohja dhe promovimi i të drejtave të fëmijës duhet bërë në vazhdimësi nga Komuna, për të siguruar shërbime efikase dhe cilësore për fëmijë, dhe poashtu duhet punuar në avancimin e materialeve dhe kurrikulave shkollore për të drejtat e fëmijëve dhe të organizohen trajnime të vazhdueshme për profesionistët në mënyrë që ato të interpretohen dhe zbatohen përshtatshëm.

Në vijim, në formë tabelare janë përmbledhur ndërhyrjet nga më lartë, sipas një ndarje reale të përgjegjësisë, aktiviteteve, afateve të përmbushjes, treguesve dhe shpenzimeve, të cilat do t'i ndërmarrë niveli komunal në mënyrë që ky Plan i Veprimit të jetë në periudhën e parashikuar 2019 - 2021, periudhë gjatë së cilës aktivitete dhe nën-aktivitete tjera do të shtohen sipas nevojës dhe qëllimit të planit.

Objektiva 1:**Komuna e Prishtinës do t'i përfshijë fëmijët, në të gjitha vendimet që do t'i marrë lidhur me fëmijët dhe çështjet e tyre**

Aktiviteti	Afati Kohor	Zbatuar nga	Përkrahur nga	Rezultati	Treguesi	Kostoja
Organizimi i pjesëmarrjes së fëmijës në proceset e vendimmarrjes që kanë të bëjnë me fëmijët në komunë.	36 muaj	DAK, DMS DSH, DK DS, OJQ; Asambleja e Fëmijëve; Mekanizmi Koordinues; Zyra e Kryetarit; NJDNJ.	Komuna Donatorët	Mendimet e fëmijëve janë konsideruar dhe fëmijët janë njoftuar për këtë.	# i vendimeve # i takimeve # i fëmijëve të përfshirë	Pa kosto

Objektiva 2:**Komuna do të promovojë kujdesin shëndetësor, arsimor- edukativ dhe kujdesin alternativ**

Aktiviteti	Afati Kohor	Zbatuar nga	Përkrahur nga	Rezultati	Treguesi	Kostoja
Organizimi i fushatave promovuese, përgatitja dhe nxjerrja e broshurës për kujdesin shëndetësor, arsimor- edukativ dhe kujdesin alternativ.	36 muaj	QKMF Shkolla QPS OJQ	Komuna Donatorët	Publikimi dhe shpërndarja e broshurës informative për kujdesin shëndetësor, arsimor- edukativ dhe kujdesin alternativ.	# broshurave të publikuara # takimeve me QKMF # takimeve me shkolla # takimeve me QPS # takimeve me prindër # takimeve me OJQ	6000 EURO

Objektiva 3:**Komuna do të promovojë mbrojtjen dhe parandalimin nga abuzimi, dhuna dhe shfrytëzimi, apo çfarëdo rreziku tjetër.**

Aktiviteti	Afati Kohor	Zbatuar nga	Përkrahur nga	Rezultati	Treguesi	Kostoja

Aktiviteti	Afati Kohor	Zbatuar nga	Përkrahur nga	Rezultati	Treguesi	Kosto
Organizimi i Fushatave vetëdijësuese, grupeve/forumeve/tryeza ve të rrumbullakëta/ për parandalimin dhe mbrojtjen nga abuzimi, dhuna dhe shfrytëzimi apo rreziku tjetër	36 muaj	DAK DMS DSH DK DS OJQ Asambleja e Fëmijëve Mekanizmi Koordinues Zyra e Kryetarit NJDNJ Policia e Kosovës	Komuna dhe donatorët	Vetëdijesimi i fëmijëve dhe komunitetit lidhur me mbrojtjen dhe parandalimin nga abuzimi, dhuna dhe shfrytëzimi, apo rreziku tjetër.	# i takimeve/tryezave/forumeve # i pjesëmarrësve	1800 EURO

Objektiva 4.

Komuna do të sigurojë qasje në hapësira dhe të mundësojë lojëra dhe argëtim për të gjithë fëmijët e komunës

Aktiviteti	Afati kohor	Zbatuar	Përkrahur	Rezultati	Treguesi	Kosto
Krijimi i ambienteve për lojëra dhe argëtim, organizimi për qasje të sigurtë për lojëra dhe argëtim në parqe dhe mjedise rekreative. Organizime shënues (p.sh. për fëmijë të grupmoshave	12 muaj	Drejtoria e parqeve Drejtoria e infrastrukturës Drejtoria për planifikim hapësinor Mekanizmi Koordinues dhe OJQë	Komuna Donatorët	Qasja në parqe (gjendja e parqeve)	#i parqeve në raport me banesat kolektive	5000 EUR

të caktuara për tema të caktuara)	36 muaj		Komuna Donatorët	Fëmijët janë pjesë e lojërave dhe argëtimit në ditët e shënuara për fëmijët	# i ditëve (p.sh. pesë ditë) # i fëmijëve pjesëmarrës	500 EURO (për aktivitet)
Pjesëmarrja në aktivitete kulturore dhe sociale			Komuna dhe donatorët	Përfshirja e të gjithë fëmijëve /dhe sigurimi përhershëm i pjesëmarrjes së grupeve të fëmijëve të marginalizuar.	# i fëmijëve/pjesëmarrrës në aktivitet # i organizimeve	

Objektiva 5:

Komuna do të vlerësojë dhe mundësojë qasje në shërbime, si në ujë të pijshëm dhe në higjienë

Aktiviteti	Afati kohor	Zbatuar	Përkrahur	Rezultati	Treguesi	Kosto
Identifikimi dhe adresimi i qasjes për ujë të pijshëm dhe higjienë	12 muaj	Komuna	Komuna Donatorët	Komuna ka qasje në ujë të pijshëm dhe higjienë;	# i fëmijëve që kanë qasje në ujë të pijshëm (zona rurale/pjesë të distancuara	2000 EURO (për vlerësim)

				Secili fëmijë në Komunën e Prishtinës ka qasje në ujë të pijshëm dhe në higjienë	urbane apo grupe të marginalizuara) # Raportet nga terreni/Inspektimet	
--	--	--	--	--	---	--

Objektiva 6:

Komuna do të caktojë së paku një person përgjegjës për të drejtat e fëmijëve që i raporton Kryetarit për gjendjen e të drejtave të fëmijëve

Aktiviteti	Afati kohor	Zbatuar	Përkrahur	Rezultati	Treguesi	Kosto
Caktimi i personit përgjegjës për të drejtat e fëmijëve	1-6 muaj	Kryetari (me vendim)	Komuna	Përbushja e detyrave nga Rregullorja/Plani Komunal i Veprimit	Punësimi/emërimi i personit përgjegjës	Sipas Katalogut/përshkrimit të detyrave

Objektiva 7:

Komuna do të bashkëpunojë me të gjitha komunat, institucionet publike dhe OSHCtë në përmbushjen e detyrave të saja ligjore

Aktiviteti	Afati kohor	Zbatuar	Përkrahur	Rezultati	Treguesi	Kosto
Organizimi i punës së përbashkët ndër-komunale dhe ndër-institucionale, dhe me OSHC, përmes konsultimeve,	36 muaj	Mekanizmi koordinues	Komuna Donatorët	Bashkëpunimi & bashkërendimi midis institucioneve	Rregullorja komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe	Nuk ka kosto

takimeve/tryezave dhe organizimeve tjera për fëmijët dhe çështjet lidhur me fëmijët				dhe shoqërisë civile i vënë	legjislacioni tjetër përkatës për fëmijë; # i Marrëveshjeve të bashkëpunimit	
---	--	--	--	-----------------------------	---	--

Objektiva 8:
Komuna do të themelojë Mekanizmit Koordinues për mbrojtjen e fëmijëve, sipas mandatit të sajë ligjor

Aktiviteti	Afati kohor	Zbatuar	Përkrahur	Rezultati	Treguesi	Kosto
Themelimi i Mekanizmit Koordinues dhe përcaktimi i detyrave të punës	1 - 3 muaj	Komuna	Komuna OShC	Identifikimi dhe përfshirja e akterëve kyç	Nxjerrja e Vendimit për themelimin e MK-së	400 EUR (4 X takime, në vit), dhe sipas nevojës

Objektiva 9:
Komuna do të vlerësojë dhe hartojë politika dhe akte ligjore lokale për fëmijët dhe gjendjen e fëmijëve në Komunë.

Aktiviteti	Afati kohor	Zbatuar	Përkrahur	Rezultati	Treguesi	Kosto
Vlerësimi i ndikimit të politikave, legjislacionit për gjendjen e fëmijëve	Në çdo 12 muaj	MK Komuna	Komuna OJQ	Përmirësimi dhe përditësimi i politikave dhe legjislacionit	Raporti për vlerësimin e ndikimit	Pa kosto

Objektiva 10:

Komuna do të vendosë një sistem të raportimit për gjendjen e fëmijëve që i përgjigjet mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Aktiviteti	Afati kohor	Zbatuar	Përkrahur	Rezultati	Treguesi	Kosto
Zhvillimi i sistemit të raportimit për gjendjen e fëmijëve	1- 6 muaj	MK Komuna	Komuna OJQ	Vendosja e sistemit të raportimit	# i formave/ modeleve të zhvilluara të raportimit	Pa kosto

Objektiva 11:

Komuna do të përcaktojë planin buxhetor për realizimin e të drejtave të fëmijëve nën juridiksionin e vetë.

Aktiviteti	Afati kohor	Zbatuar	Përkrahur	Rezultati	Treguesi	Kosto
Planifikimi i buxhetit për fëmijë Përcaktimi i një formule të veçantë buxhetore për fëmijë	Çdo 3 vite - plani i përgjithshëm Cdo vit plani i veçantë/rishi kues	Komuna/Drejtori a përkatëse (apo Drejtoria nga vjen personi përgjegjës i emëruar/si më lartë)	Konsultim me Kabinetin	Buxheti i mjaftueshëm për realizimin e të drejtave të fëmijëve	Plani buxhetor Vendimi	Pa kosto

Objektiva 12:

Komuna do të promovojë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve bazuar në Rregulloren Komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Aktiviteti	Afati kohor	Zbatuar	Përkrahur	Rezultati	Treguesi	Kosto
-------------------	--------------------	----------------	------------------	------------------	-----------------	--------------

Buxheti i përgjithshëm i parashikuar me këtë Plan të Veprimit prej **18 200 EURO**, i përcaktuar nga Grupi Punuesështë shumë i arritshëm për ta zbatuar planin në tërësi.

Objektivat e përshkruara më lartë si pjesë e këtij Plani të Veprimit, do të jenë pjesë e Planeve tjera për t'u zhvilluar dhe përditësuar nga Komuna në raport me nevojat e fëmijëve dhe shpenzimet për fëmijët, me qëllimin parësor për t'ju ofruar atyre shërbime sa më të mira dhe sa më profesionale.

Plani i veprimit, poashtu mendohet që ta orientojë punën e mëtejme që në vazhdimësi do të bëhet nga Komuna për avancimin e shërbimeve për fëmijë nën kornizën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.